



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V_308_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_475_10_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_475_10_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Fatmir Zeqiri nga Gjilani (shifra e konsumatorit DGL – 9004155), si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 12.01.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 21.11.2008 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 29.01.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se konsumatori nuk posedon njehsorin e vjetër dhe se kanë marrë shënimet e njehsorit të ri.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 011761 të datës 29.01.2008

- Me datë 29.01.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë vendosur njehsorin e ri elektrik nr. 44059244, ndërsa te pjesa e njehsorit të vjetër është evidentuar se konsumatori nuk posedon njehsorin i vjetër.

Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000011 të datës 29.01.2008

- Me datë 29.02.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike me anë të faturës DGL08HP01394 në vlerë 9,047.56 €.

Provë: Fatura DGL08HP01394 të datës 29.02.2008

- Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 21.11.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se kërkesa e konsumatorit nuk mund të korrigohet për arsye se mungojnë dëshmitë për gjendjen e njehsorit të vjetër.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 21.11.2008
- Me datë 12.01.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 08.12.2009 DMK në pajtim me paragrafin 14.3 të nenit 14 të Rregullit mbi Procedurën për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ka analizuar ankesat e konsumatorëve dhe ka vlerësuar se zyrtarët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse gjatë përpilimit të procesverbaleve nuk kanë shënuar shumat e fuqive të shpenzuesve të inventarizuara me rastin e inspektimit të pikave matëse tek konsumatorët komercial dhe industrial ka kthyer në rishqyrtim lëndën e konsumatorit. Sipas kësaj KEK-u ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar.
Provë: Shkresa e DMK-së dërguar KEK-ut (Departamentit për Konsumator) për rishqyrtimin e ankesave të konsumatorëve
- Me datë 21.05.2010 Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrjetit dhe furnizuesit publik, ka pranuar pjesërisht ankesën e konsumatorit.
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Pasi që DMK e ka dërguar lëndën e konsumatorit në rishqyrtim në KEK, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me datë 28.01.2010 për të marrë pajisjet elektrike që posedon konsumatori.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 125009 të datës 28.01.2010
- ✓ Komisioni i KEK-ut pasi ka marrë lëndën e konsumatorit në rishqyrtim, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *“konsumatori njehsorin nr. 2117023 e ka ndërruar para periodës 05/2007. Konsumatori, sipas listës së leximit 5/2007 ka pasur aktive njehsorin nr. 44059244 me gjendje A1=18688 kW. Me dt. 09.01.2008 është plotësuar procesverbali i ndërrimit të njehsorit nr. 000011 sipas të cilit konsumatori nuk ka prezantuar njehsorin e vjetër. Në bazë të këtij procesverbali nr. 000011, është llogaritur fatura interne e RH sipas të cilit edhe ka rezultuar fatura nr. DGL08HP01394 dt. 29.02.2008 në vlerë 9,047.56 €. Vërejtje: Fatura interne në bazë të cilit llogaritet fatura e RH, sipas Proc. Perk. Për idenë. Dhe paran. Duhet të bazohet në pajisjet të pajisjet të cilat i furnizon pika matëse e jo në siguresa siç është llogaritur RH. Njehsori është ndërruar gati 1 vit para procesverbalit të ndërrimit të njehsori nr. 000011 dhe në momentin e ndërrimit ka pasur të regjistruar 18688 kW. Shpenzimi mesatar i energjisë që është regjistruar në periudhën e RH për njehsorin që nuk prezantohet është 48 kW. Konsumatori ka bërë edhe dy ndërrime të njehsorëve sipas të cilëve energjia mesatare e regjistruar është 1459 kW gjegjësisht me njehsorin aktual 1040 kW. Rillogaritja e RH me pajisje sipas procesverbalit të klontrrollës rezulton në vlerë 9,573.18 €. Deri në periodën P5/2007 lokali ka punuar si frizer dhe pas kësaj është ndërruar edhe pronari edhe veprimtaria. Vendimi i komisionit: Qëndrojmë pas vendimit të datës 29.02.2008*

Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 26.01.2010

- ✓ Komisioni i KEK-ut në vendimin e tyre pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *konsumatori njehsorin nr. 2117023 e ka ndërruar para periodës 05/2007. Konsumatori, sipas listës së leximit 5/2007 ka pasur aktive njehsorin nr. 44059244 me gjendje A1=18688 kW. Me dt. 09.01.2008 është plotësuar procesverbali i ndërrimit të njehsorit nr. 000011 sipas të cilit konsumatori nuk ka prezantuar njehsorin e vjetër. Shpenzimi mesatar i energjisë elektrike për njehsorin i cili nuk prezantohet është 48 kWh e që është shumë i vogël në krahasim me shpenzimin mesatar të regjistruar në dy njehsorët "e ri". Njehsori nr. 440863679 ka regjistruar shpenzimin mesatar mujor 1040 kWh kurse njehsori nr. 44059244 ka regjistruar shpenzimin mesatar mujor 1459 kWh. Nga faktet e lartcekura, në bazë të nenit 4 dhe 12 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike është llogaritur fatura interne e RH sipas të cilit ka rezultuar fatura nr. DGL08HP01394 dt. 29.02.2008 në vlerë 9,047.56 €. Rillogaritja e RH sipas pajisjeve nga procesverbali nr. 125009 dt. 28.01.2010 rezulton në vlerë 9,573.18 €. Por pasi evidentimi i këtyre pajisjeve është bërë në një periudhë tjetër nga periudha e rikthimit të humbjeve, komisioni qëndron pran vendimit ekzistues.*
Provë: Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

- ✓ KEK-u edhe përkundër asaj që DMK ka kthyer në rishqyrtim ankesën e konsumatorit dhe i ka konstatuar se KEK nuk ka vepruar sipas nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, KEK-u prapë ka refuzuar ankesën e konsumatorit, duke mos e marrë për bazë shkeljen e procedurës

- ✓ Sipas listave të leximit të (KEK-ut), lexuesi i KEK-ut në periudhën 04/2007 ka evidentuar se nuk ka çasje; në periudhën 05/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244; në periudhën 06/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244; në periudhën 07/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244; në periudhën 08/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244; në periudhën 09/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244; në periudhën 10/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244; në periudhën 11/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik; në periudhën 12/2007 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244; në periudhën 01/2008 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244; në periudhën 02/2008 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe ka marrë gjendjen e njehsorit elektrik nr. 44059244.

Provë: Listat e leximit të KEK-ut

- ✓ Me datë 03.03.2006 konsumatori Fatmir Zeqiri ka nënshkruar kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me Osman Ibrhaimaj. Kjo kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjiilan me datë 31.03.2006

Provë: Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e datës 03.03.2006

- ✓ Me datë 14.04.2006 Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronësi, Gjilan ka lëshuar kopjen e planit nr.11-616/2006. Provë: Kopja e planit nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronësi, Gjilan nr. 11-616/2006 e datës 14.04.2006
- ✓ Me datë 09.05.2006 Drejtoria për urbanizëm, rindërtim dhe ambient në Komunën e Gjilanit ka lëshuar Leje urbanistike, me anë të cilës Fatmir Zeqirt nga Cërnica, i caktohen kushtet e përkohshme tekniko-urbanistike për ndërtimin e objektit ekzistues të banimit individual.
Provë: Leje urbanistike nga Drejtoria për urbanizëm, rindërtim dhe ambient në Komunën e Gjilanit nr.07-352/312 të datës 09.05.2006
- ✓ Me datë 09.06.2006 Drejtoria për urbanizëm, rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit ka lëshuar Aktvendimin (leje ndërtimi) nr. 07-352-388, ku Fatmir Zeqirit nga Cërnica, Gjilan i me kushte të përkohshme urbanistiko-teknike i Lejohet rindërtimi i objektit individual banimo-afarist.
Provë: Aktvendimi (leje ndërtimi) nr. nga Drejtoria për urbanizëm, rindërtim dhe Ambient e Komunës së Gjilanit nr. 07-352-388 të datës 09.06.2006
- ✓ Me datë 28.05.2007 konsumatori ka nënshkruar kontratën për shërbimet e energjisë elektrike me KEK.
Provë: Kontrata për shërbimet e energjisë elektrike me KEK e datës 28.05.2007
- ✓ Sipas analizave të bëra listave të leximit vërehet se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 44059244 ka qenë i vendosur para periudhës 05/2007. Sipas listave të leximit të KEK-ut gjendja e njehsorit elektrik nr. 44059244, në tarifën e lartë ka qenë 2157 kW, ndërsa në tarifën e ulët ka qenë 8 kW, ndërsa në analizën e anëtarëve të komisionit të KEK-ut bërë lëndës së konsumatorit kanë theksuar se sipas listës së leximit 5/2007 konsumatori ka pasur aktive njehsorin nr. 44059244 me gjendje në tarifën e lartë 18688 kW. Kjo analizë e KEK-ut nuk qëndron ngase lista e leximit e vet KEK-ut e tregon gjendjen e njehsorit se në tarifën e lartë janë evidentuar 2157 kW e jo siç kanë theksuar komisioni i KEK-ut. Në procesverbalin e kontrollës së KEK-ut punëtorët e autorizuar të KEK-ut nr, 011761 të datës 29.01.2008 kanë evidentuar se gjendja e shpenzimit të njehsorit elektrike nr. 44059244 në tarifën e lartë është 18,688 kW.
- ✓ KEK-u edhe përkundër asaj që lexuesi i KEK-ut e ka evidentuar që nga periudha 05/2007 e tutje se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik dhe se ka marrë gjendjen e kilovatëve, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori me datë 29.01.2008. KEK-ut iu është dashur 10 muaj që të inspektoj dhe regjistroj njehsorin e ri nr. 44059244.
- ✓ Sipas analizave të bëra listave të leximit të KEK-ut dhe gjendjes të cilën e ka evidentuar lexuesi i KEK-ut, vërehet se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike prej 05/2007 e deri te 02/2008 është **1,986.6 kWh/muaj**.
Provë: Listat e leximit të KEK-ut
- ✓ Sipas transaksioneve të konsumatorit dhe rrjedhës së energjisë vërehet se prej periudhës 01/2003 e deri 07/2005 nuk ka faturim të shpenzimit të energjisë elektrike. Po ashtu edhe pas periudhës 07/2005 e deri kur është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik vërehet se nuk ka harxhim të shpenzimit të energjisë elektrike, por në disa periudha KEK-u konsumatorin e ka ngarkuar me faturim pa matje – paushall.
Provë: Transaksionet e konsumatorit dhe rrjedha e energjisë elektrike

- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit theksohet se me datë 03.03.2006 konsumatori ka blerë truallin me sipërfaqe prej 0.01.29 ha dhe shtëpinë e vjetër nga Osman Ibrahimaj. Me rastin e blerjes së truallit dhe shtëpisë jemi pajtuar që shpenzimet e energjisë elektrike të mëparshme t'i paguan pronari i mëhershëm i cili i ka kryer me datë 04.04.2006 në vlerë prej 402 €. Pas kësaj kam rrënuar shtëpinë e vjetër dhe se njehsori elektrik ka qenë aty me mbeturina dhe se pa qëllim është hedhur njehsori elektrik. Nga ai moment unë të gjitha shpenzimet i kam marrë dhe i kam paguar. Borxh të papaguar të mëhershëm nuk ka pasur dhe se të ngarkohem se mungon njehsori i vjetër nuk është në rregull dhe se ai njehsori pa qëllim është hedhur.

Provë: Deklarata e konsumatorit

- ✓ Në periudhën 07/2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin njehsorit elektrik, ku kanë hequr njehsorin elektrik nr. 44059244 dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 40863679. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut gjatë demontimit të njehsorit të vjetër kanë dëmtuar kapaku kryesor.

Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 00093

DMK duke marrë parasysh analizat e bëra dhe argumentet e paraqitura, ka rekomanduar Bordin e ZRRE që të **pranojë** ankesën e konsumatorit dhe të vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet ta shkarkoj konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DGL08HP01394 në vlerë 9,047.56 €, të datës 29.02.2008.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DGL08HP01394 në vlerë 9,047.56 €, të datës 29.02.2008.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar